**AKT THEMELIMI**

**I SHOQËRISË TREGTARE**
**"   VERSION   " SH.P.K**
**ME SELI NË TIRANË**

***

Sot, më datë 20/06/2023, në Tiranë,

***Pranvera Doci*** shtetas shqiptar, i lindur më 14/03/1988 në Q.Reps, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me kartë identiteti Nr **ID I85314081I**

I cili ka vendosur themelimin e shoqërisë **VERSION Sh.P.K.,** shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, me termat e mëposhtme:

**NENI 1**

Shoqeria **VERSION Sh.P.K.,** është formuar si shoqëri tregtare sipas ligjit 9901 e datës 14/04/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", (në vazhdim Shoqëria).

Shoqëria është Person Juridik Privat Shqiptar. Shoqëria ka selinë e saj në Tiranë dhe do të mund të vendos ose heq seli sekondare, zyra sekondare përfaqesimi dhe agjenci në Shqipëri edhe jashtë shtetit.

**NENI 2**
**Emri i shoqërisë**

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin **VERSION**

**NENI 3**
**Objekti i veprimtarisë**

Shoqeria ka për objekt - në përputhje me kërkesat ligjore - veprimtaritë e mëposhtme:

*Sherbim konsulence per fondet e investimeve te koorporatave brenda dhe jashte Shqiperise. Analiza dhe studime te tregut ne funksion te ketyre fondeve te investimit. Publikim te kompanive qe zhvillojne politikat green dhe ndihmojne ne permiresimin e problemeve mjedisore.*

**NENI 4**
**Selia e Shoqërisë**

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën Tirane, Albania: Rruga Xhemal Tafaj , pasuria nr.9/33 , Volumi 8 , faqe 184 , zona kadastrale nr.8370, Tiranë 1015

**NENI 5**
**Kapitali i Shoqërisë**

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i nje ortakut te vetem themeluesi i kësaj Shoqërie në para në vlerën 100 (njëqind) lek.

Themeluesi merr në pronësi kuotën **100%** në kapitalin themeltar në përputhje me kontributin e tij.

Kontributi i ortakëve themelues në kapitalin themeltar është si më poshtë:

***Znj. Pranvera Doci , 1 kuotë , me vlerë 100 Lek, zotëron 100 % (njëqind).***

**NENI 6**
**Kohëzgjatja e shoqërisë**

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar.

**NENI 7**
**Organet Drejtuese**

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve;
2. Administratori .

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë. Shoqëria do të administrohet fillimisht nga Administratori i vetem i cili zgjidhet me afat pesëvjeçar të ripërtërishëm përveç rasteve të revokimit ose të dorëheqjes ose shkaqeve të tjera ligjore.

***Administratori i Shoqërisë i cili pranon do të jetë Znj. Pranvera Doci, shtetas shqiptar,i lindur më 14/03/1988, lindur në Q.Reps dhe banuese në Tirane), person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me ID I85314081I.***

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratorët, të cilët i ushtrojnë këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
Shoqëria është e administruar nga një administrator i vetëm, edhe jo ortak ose nga shumë administrator, edhe jo ortak, sipas asaj që është përcaktuar në aktin e emërimit.
Kur administrimi i shoqërisë i është besuar disa personave, akti i emërimit vendos në alternative:
a) nëse administratorët do të veprojnë në mënyrë kolegjiale duke themeluar kështu këshillin e administrimit
b) nëse administrimi është caktuar bashkarisht ose jo bashkarisht.

**NENI 8**

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe Statutit.

**NENI 9**

Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

**NENI 10**
**Ligji i aplikueshëm**

Veprimtaria e shoqërisë rregullohet nga rregullat e Statutit të firmosur nga ortakët themelues sipas parashikimeve të ligjit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

**NENI 11**
**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me themelimin e Shoqërisë do të zgjidhen nga Ortakët, në rast të kundërt do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Tiranë.

**NENI 12**
**Dispozitat përfundimtare**

Akt Themelimi hartohet në katër kopje në gjuhën shqipe dhe u lexua nga Ortakët Themelues, te cilët e gjetën atë në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe e nënshkruan pa vërejtje.

**ORTAKËT THEMELUES**

PRANVERA DOCI